



Data: 18.05.2018

Ref.: 460/MBD

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit institucional të Kolegji “UBT”, për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019.
- II. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegji “UBT”, të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2018 – 30 shtator 2019:
 - Farmaci, MPh (Integrated) 300 ECTS;
 - Stomatologji, Dr.Dent (Integrated) 360 ECTS.
- III. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegji “UBT”, të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2020:
 - Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS (Prishtinë, Ferizaj, Prizren); (me specializim në: 1. Arkitekturë e Qëndrueshme, 2. Menaxhim Urban, 3. Restaurimi Arkitektural, Dizajn Enterier)
 - Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, BSc, 180 ECTS;
 - Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, MSc, 120 ECTS; (me specializim në: 1. Inxhinieri Strukturore, 2. Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe Teknologji, 3. Infrastrukturë Rrugore, 4. Inxhinieri e Ujrave, 5. Inxhinieri e Ujërave, 6. Inxhinieri e Gjeoteknikës, 7. Inxhinieri e Materialeve)
 - Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, BSc, 180 ECTS; (me specializime: 1. Teknologji Ushqimore; 2. Nutricion (Të ushqyerit); 3. Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë së ushqimit).
 - Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS;
 - Juridik, LLB, 240 ECTS; (me specializim në: 1. Civil, 2. Penal, 3. Ndërkombëtar)
 - Media dhe Komunikim, BA, 180 ECTS;
 - Infermier, BSc, 180 ECTS;
 - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS; (me specializim në: 1. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, 2. Integritet Evropian, 3. Administratë Publike)
 - Politika Publike dhe Menaxhimi, MA, 120 ECTS;

- Sistemet e Informacionit dhe Menaxhment, MSc, 120 ECTS;
 - Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS;
 - Media dhe Komunikimi, MA, 120 ECTS;
 - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS (me specializim në: 1. Financa dhe Kontabilitet Bankar, 2. Marketing dhe Shitje, 3. Ndërmarrësia dhe Inovacioni, 4. Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit)
- IV. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegji "UBT", të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021:
- Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, Level V, 120 ECTS; (me specializime: Burimet e Energjisë; Konzervimi i Energjisë; Eficenca e Energjisë; Menaxhimi i Energjisë; Inxhinieri Elektrike; Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa; Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes; Energjia Gjeotermike)
 - Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS; (me specializim në: 1. Burimet e Energjisë; 2. Konzervimi i Energjisë; 3. Eficenca e Energjisë; 4. Menaxhimi i Energjisë; 5. Inxhinieri Elektrike; 6. Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa; 7. Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes; 8. Energjia Gjeotermike)
 - Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, MSc, 120 ECTS;
 - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, BA, 180 ECTS.
- V. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegji "UBT", të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2022:
- Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS, (Prishtinë, Prizren); (me specializim në: 1. Inxhinieri e Sistemeve Softuerike; 2. Databaza dhe Sisteme të Informacionit; 3. Grafik dhe Multimedia; 4. Web Programimi; 5. Rrjeta dhe Telekomunikacion; 6. Robotikë dhe sisteme Intelgjente; 7. Informatikë Biomjeksore; 8. Siguria dhe sigurimi i Informacionit);
 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, MSc, 120 ECTS; (me specializim në: 1. Inxhinieri e Sistemeve Softuerike; 2. Sistemet e Databazës; 3. Web Programimi; 4. Inxhinieri e Komunikimit; 5. Shkenca e të Dhënave Statistikore; 6. Informatikë Mjekësore)
 - Menaxhim i Mekatronikës, BSc, 180 ECTS; (me specializime: 1. Menaxhimi i Mekatronikës; 2. Automatizim Industrial dhe Kontrolli i Procesit; 3. Dizajn i Produkteve Industriale; 4. Robotikë dhe Sisteme Intelgjente; 5. Inxhinieri Biomjekësore; 6. Inxhinieri e Telekomunikimit; 7. Inxhinieri Mekanike; 8. Inxhinieri e Aeronautikës);
 - Menaxhim i Mekatronikës, MSc, 120 ECTS (me specializim në: 1. Menaxhimi i Mekatronikës, MSc, 120 ECTS, (me specializime: 1. Menaxhimi i Maratonikes; 2. Dizajn i Produkteve Industriale; 3. Inxhinieri e Proceseve të Prodhimit dhe Teknologjia)
- VI. Kuotat për regjistrimin e studentëve në programet respektive, vlejné sipas vendimit të fundit të KSHC-së për ri/akreditimin të programeve studimore përkatëse.

Arsyetimi

I. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit institucional dhe të programeve të studimit për Kolegjin "UBT", ashtu siç është përcaktuar në paragrafin I dhe II të këtij vendimi. Duke pasur parasysh se dinamika e AKA-së për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë është ndërprerë për 7 muaj dhe se procesi i vlerësimit të jashtëm nuk është organizuar, vizita me ekspertë ndërkombëtar nuk është realizuar sipas afateve të parapara nga AKA, dhe rrjedhimisht rrezikohet vonimi i regjistrimit të studentëve të rinj në këto programe të studimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 ka analizuar situatën e krijuar pas ndërprerjes së dinamikës së punës së AKA-së për 7 muaj dhe pasojave eventuale që mos funksionimi i AKA-së për 7 muaj (15 Shtator 2017 - 22 Prill 2018) mund ti sjellë procesit të akreditimit dhe të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Në këtë drejtim, KSHC i AKA-së me qëllim që procesi i vlerësimit dhe akreditimit të mos mbi ngarkohet dhe mos dyfishohet me rastin e fillimit të procesit të ri të akreditimit mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit, për periudhën një vjeçare, për gjitha programet e studimit të Kolegjit "UBT" të cilat kanë akreditim të vlefshëm sipas vendimeve përkatëse të KSHC-së, të cekura në paragrafin III, IV dhe V të këtij vendimi.

Marrë parasysh rrethanat e krijuara për arsye të mos funksionalizimit të KSHC-së të AKA-së për 7 muaj, për situatën e jashtëzakonshme të krijuar për IAL-të dhe procesin e vlerësimit dhe akreditimit, duke pasur parasysh ndeshjen e afateve ligjore për sa i përket procesit të aplikimit për ri/akreditim si dhe procesin e deklarimit të stafit akademik në përputhje me UA për Akreditim Nr. 9/2017, duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037- datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, i cili përcakton se *"Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Ky rishikim nga ana e ekspertëve do të përfshijë një inspektim të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve. Riakreditimin e një institucioni apo të një ose më shumë programeve të tij mund ta kërkojnë bordi i AKA-së ose Ministria brenda një periudhe më të shkurtër se pesë vjet."*, si dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi Kolegjin "UBT" me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.9/2017, datë 02.08.2017) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I, II, III, IV, V, VI të këtij vendimi. Në të kundërtën KSHC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërin nga mbledhjet e radhës së KSHC-së të veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriterëve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.9/2017, datë 02.08.2017.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencisë së Kosovës për Akreditim siç përcaktohet në nenin 128 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28, në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "UBT"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

